# DËSHMI ARKIVI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**A-435519**

VERSIONI 1

> **Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Hamza takon ushtruesen e detyrës së ambasadores së SHBA-së: Bllokada e institucioneve duhet të marrë fund - Euronews Albania |
| ADRESA | `https://euronews.al/hamza-takon-ushtruesen-e-detyres-se-ambasadores-se-shba-se-bllokada-e-institucioneve-duhet-te-marre-fund/` |
| BURIMI | euronews.al |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 10 shtator 2026, 17:25:26 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 10 shtator 2026, 17:20:35 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `f9432bbf51feb95ac61d557ac66fd49a3aa8239cc371ed76702f93b790e8a043` |
| TEKSTI | `8a49c035cfcff7b4b98c43ab00467c071da6a92f89d721d08ecf4039a7fd0e31` |
| PAMJA | `d73e35dd62929ab25a304fc9bd62e67ea64f6c0e268e3c66bfda18357ccc3007` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `6b862ab473e36486b2de5f9c98d171c53d1c4cdf38daf6838113d3ca4287002e` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `8df13bbbbd5b9e08ebccccfce3cb93992e5d7a04976148e68633453f6b00d682` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/6b862ab473e36486b2de5f9c98d171c53d1c4cdf38daf6838113d3ca4287002e`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

KOSOVË | LAJMI I FUNDIT

# Hamza takon ushtruesen e detyrës së ambasadores së SHBA-së: Bllokada e institucioneve duhet të marrë fund

10 Shtator 2026 | 19:20

SHPËRNDAJE ARTIKULLIN

Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës, Bedri Hamza, ka pritur sot në takim ushtruesen e detyrës së ambasadores së SHBA-së në Kosovë, Anu Prattipati.

Siç bëri të ditur PDK-ja përmes një njoftimi, në takim u diskutua për zhvillimet aktuale politike në vend, nevojën për konstituimin e Kuvendit të Kosovës dhe rëndësinë e ruajtjes së stabilitetit politik dhe institucional.

Hamza shprehu shqetësimin për zvarritjen e procesit të konstituimit të Kuvendit dhe për veprimet e partisë së parë, të cilat, sipas tij, kanë prodhuar shkelje kushtetuese dhe kanë thelluar krizën institucionale.

Kreu i PDK-së theksoi se bllokada duhet të marrë fund dhe se përgjegjësia për krijimin e institucioneve duhet të ushtrohet pa vonesa të tjera, duke respektuar vullnetin e qytetarëve, Kushtetutën dhe procedurat parlamentare.

Hamza ritheksoi qëndrimin e PDK-së se vendi ka nevojë për një Kuvend funksional dhe rikthimin e rendit kushtetues e demokratik.

Gjatë takimit u diskutua gjithashtu për rëndësinë e partneritetit strategjik ndërmjet Kosovës dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës, si dhe nevojën për koordinim të vazhdueshëm të Kosovës me partnerët e saj ndërkombëtarë.

**Shiko në:**

## LAJME TË SUGJERUARA

KOSOVË
**“Ditari i një fotografi të luftës”, ekspozita në Prishtinë para vendimit në Hagë**
Pak ditë para vendimit të madh në Hagë për ish-krerët e UÇK-së, lufta e tyre dhe e shumë ushtarëve të tjerë kundër forcave serbe

## LAJMI I FUNDIT

19:07 **Mbretëria e Bashkuar dhe Bahreini kërkojnë mbledhje të Këshillit të Sigurimit të OKB-së për Jemenin**

18:53 **“Fustani i hakmarrjes” i Princeshës Diana del në ankand**

18:49 **Sulm me thikë në Londër, 4 të plagosur dhe 7 të arrestuar**

18:43 **Pijet shumë të nxehta rrisin rrezikun e kancerit të ezofagut**

18:36 **“South Park” bëhet “South America” për t’u tallur me Trump**

18:20 **Del në dritë një dosje sekrete mbi “Engjëllin e Vdekjes” nazist**



është...

18:07 | 10/09/2026

KOSOVË

**Mbrojtja e Thaçit kërkon lirimin e tij: Vendimi duhet të bazohet në prova, jo në spekulime**

Mbrojtja e Hashim Thaçit e përfaqësuar nga avokatja, Sophie Menegon ka thënë që vendimi i trupit gjykues ndaj klientit të saj duhet të bazohet në...

18:02 | 10/09/2026

KOSOVË | LAJM KRYESOR | RAJONI

**Prokuroria në Hagë kërkon 6 vjet burgim për Hashim Thaçin**

Pas paraqitjes së fjalës përfundimtare nga kryeprokurorja Kimberly West dhe prokurori i rastit, Prokuroria e Specializuar në Hagë ka kërkuar 6 vjet burgim për ish-presidentin...

13:56 | 10/09/2026



Copyright © Euronews 2026

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.